Kronikë

Vendoset eksploziv jashtë banesës së një 51-vjeçari në Nikël! Lënda nuk ka shpërthyer, sekuestrohet nga policia

Një ngjarje tjetër është regjistruar parmbrëmë ne lagjen Zezë të Niklës, ku një sasi eksplozivi i është vënë portës së jashtme të banesës së shtetasit Sh. Mehmeti. Fatmirësisht lënda plasëse nuk ka shpërthyer dhe është konstatuar nga të zotët e banesës mëngjesin e djeshëm kur po shkonin për punë.



Foto ilustruese

Julian Shota
1 Shkurt, 17:19 | **Përditesimi: 1 Shkurt, 19:01**

Share

KRUJË - Një ngjarje tjetër është regjistruar para dy netësh ne lagjen Zezë të Niklës, ku një sasi eksplozivi i është vënë portës së jashtme të banesës së shtetasit Sh. Mehmeti.

Fatmirësisht lënda plasëse nuk ka shpërthyer, megjithëse fitili ishte djegur dhe u konstatua nga të zotët e banesës mëngjesin e djeshëm kur po shkonin për punë.

Sipas burimeve pronari i shtëpisë nuk njihet si person problematik apo që mund të ketë konflikte me njeri dhe kjo e bën më të vështirë punën për zbardhen e ngjarjes.

[Sh.com]



LEXO EDHE:
Përmbytjet në Durrës prekin edhe burgun, 40 të paraburgosur zhvendosen në qelitë e Fushë Krujës

> *'Krujë/Informacion- Paraditen e djeshme shtetasi Sh. M., 51 vjeç, ka njoftuar policinë se në afërsi të rrethimit të jashtëm të banesës së tij në Nikël, ka konstatuar 2 kallëpe dyshohet me lëndë plasëse dhe fitil zjarrpërcjelles, të cilat u sekuestruan me cilësinë e provës materiale. Grupi hetimor po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes si dhe per identifikimin dhe kapjen e autorit.', thotë policia.*

Nuk dihen shkaqet apo autorët e kësaj ngjarje por duhet theksuar që edhe pse ngjarja ka ndodhur parmbrëmë është mbajtur e fshehtë nga policia deri tani.

Kujtojmë që parmbrëmë iu vu eksploziv dhe restorantit 'Brazili i vjetër' ku aty eksplozivi shpërtheu duke shkaktuar dëme të mëdha materiale.

G.K/Shqiptarja.com

TAG: lende plasese | krujë | Durres | nikel

Komento

Komente

Ndyresirat: 01/02/2025 21:18

Ajo zona e Nikles paska mbledh me kokrra vetem llumin e vendit , jane me keq se talebanet por vetem xhaxhi i kishte ber pula ata dhe shume te tjere qe mbahen si gango sot

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni gjendjen e sigurisë në vend?

1 Shkurt, 08:43

Pozitive | Negative | I dyzuar

Lajme të tjera

VIDEO/ Tension në 'Niko Dovana', tifozët e Tiranës dhe AF Elbasanit tentojnë përplasjen fizike! Ndërhyn policia
1 Shkurt, 16:54

Përndiqte 4 të mitura vazhdimisht, arrestohet 41-vjeçari nga Fushë-Kruja! Në hetim dhe një 35-vjeçar pasagjer në makinën e të arrestuarit
1 Shkurt, 16:11

Parku Arkeologjik dhe mozaikët e Durrësit 50 vjet më parë -Kujtimet e teknikut adoleshent, Fred Shuke
Gëzim Kabashi
1 Shkurt, 14:49

Durrës/ Çahet argjinatura e kanalit të Porto-Romanos, banorët akuzojnë firmën dhe kërkojnë ndërhyrje: Rrezikohet katastrofa, të ndërhyhet
31 Janar, 14:13

Durrës/ Kanosi borxhliun për 1200 euro dhe i grabiti makinën, 'Debt' prangos 37-vjeçarin e kërkuar! I gjenden drogë dhe municion (EMRI+VIDEO)
31 Janar, 13:11

KPA lë në fuqi shkarkimin e prokurorit të Durrësit Ilir Turja
30 Janar, 21:11

Durrës/ 300 banesa të përmbytura, evakuohen 6 familje, akomodohen te Konvaleshenca! 40 ha tokë nën ujë! FOTOT ME DRON
30 Janar, 08:44

Shiu përmbyt Durrësin/ Situatë problematike në Shkozet e rruga 'Bisht Kamza'! 40 shtëpi nën ujë, shpëtohen 4 fëmijë të bllokuar në furgonin e shkollës (VIDEO + FOTO)
29 Janar, 13:31

Durrës/ I dënuar për tentativë vjedhjeje dhe i dyshuar për plagosje, arrestohet 28-vjeçari i kërkuar (EMRI)
29 Janar, 13:11

Kërcënoi me armë një person gjatë një konflikti, arrestohet 30 vjeçari në Durrës (EMRI)
29 Janar, 11:50

Durrës/ Aksident në mbikalimin e Shkozetit, manovra e gabuar përplas disa automjete
28 Janar, 10:04

Durrës/ I kërkuar në Itali për trafik droge, arrestohet 32-vjeçari shqiptar me qëllim ekstradimin (EMRI)
28 Janar, 10:00

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kësaj faqeje